

## M A R R E V E S H J E

### E PARTIVE POLITIKE SHQIPTARE

Partitë politike, të ftuara në takim nga Presidenti i Republikës Sali Berisha u njohën dhe diskutuan Platformën e Pajtitimit Kombëtar, lidhur me situatën aktuale në vend: Partia Demokratike, Partia Socialiste, Partia Republikane, Partia Bashkimi për të Drejtat e Njeriut, Partia Balli Kombëtar, Partia Socialdemokrate, Partia Aleanca Demokratike, Partia Bashkimi Socialdemokrat, Partia Lëvizja e Legalitetit dhe Partia Demokristiane

#### **bien dakord që:**

1- Parlamenti shqiptar të shpallë amnistinë e përgjithshme për të gjithë ata civilë dhe ushtarakë që u implikuan në revoltën e fajdeve.

2- Të krijohet një Qeveri e Pajtimi Kombëtar me përfaqësimin e të gjitha forcave politike në dialog.

3- Brenda një afati një javor të dorëzohen armët dhe municionet nga të gjithë qytetarët, në të gjitha rrethet e Shqipërisë.

4- Dita e djelë, datë 16 Mars 1997, të shpallet ditë zie kombëtare, për të nderuar të gjithë ata që humbën jetën gjatë kësaj periudhe.

5- Të zhvillohen zgjedhjet parlamentare në një periudhë jo më larg se muaji Qershor, 1997.

6- Zgjedhjet parlamentare të zhvillohen nën mbikqyrjen e plotë ndërkombëtare.

7- Qeveria në bashkëpunim me institucionet ndërkombëtare dhe të vendit duhet të marrë të gjitha masat për të ndihmuar me përparësi zonat e dëmtuara.

8- Të fillojë lehtësimi i gjendjes së jashtëzakonshme deri në heqjen e saj sa më të shpejtë.

9- Partitë të vazhdojnë dialogun.

### **Presidenti i Republikës**

<b>PD</b>	<b>PS</b>	<b>PR</b>	<b>PBDNJ</b>	<b>PBK</b>
<b>PSD</b>	<b>PAD</b>	<b>PBSD</b>	<b>PLL</b>	<b>PDK</b>

**P.S./1** Kësaj marrëveshjeje i bashkëngjitet dhe ftesa drejtuar Partisë Socialiste nga të gjitha partitë për t'u futur në Parlament, duke vlerësuar se kjo do të ndikonte pozitivisht në situatën aktuale.

**P.S./2** Partia e Ballit Kombëtar është dakord me këtë platformë, por nuk e firmosi atë sepse mendon se qeveria duhet të quhet Qeveri e Mirëkuptimit Kombëtar dhe jo Qeveri e Pajtimit Kombëtar.

**Tiranë, më 9 Mars 1997**